L I G J
Nr. 8716, datë 15.12.2000

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8437, DATË 28.12.1998, "PËR AKCIZAT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", NDRYSHUAR ME LIGJIN NR.8507, DATË 7.7.1999 DHE LIGJIN NR.8595, DATË 6.4.2000

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Në ligjin nr.8437, datë 28.12.1998 "Për akcizat në Republikën e Shqipërisë", ndryshuar me ligjin nr.8507, datë 7.7.1999 dhe ligjin nr.8595, datë 6.4.2000 bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në nenin 3 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:
"Shkronja "A: Duhan e prodhime duhani" dhe shkronja "B: Pije alkoolike, alkoole" ndryshohen si vijon:

"Kapitulli	Kodi N.C	Përqindja e akcizës	Vlera e akcizës për një pullë
24	**A. Duhan e prodhime duhani**		
- 24.03	Duhan për konsum	60	
- 24.02	Cigare, kat.I dhe II		11 lekë/paketa
	kat.III		7 lekë/paketa
- 24.02.1000	Puro		2.240 lekë/kg
22	**B. Pije alkoolike, alkoole**		
- 22.03.00	Birrë	50	
- 22.04	Verë		
	- Me vlerë deri 300 lekë/litri		50 lekë/litri
	- Me vlerë mbi 300 lekë/litri		150 lekë/litri
- 22.08	Raki, konjak, uzo, vodka, fërnet, ponç, likerna, wiski, campari, rum, martini e të tjera pije alkoolike		
	- Me vlerë deri 400 lekë/litri		40 lekë/litri
	- Me vlerë mbi 400 lekë/litri		350 lekë/litri
- 22.07	Alkool etilik jo i denatyruar i një force alkoolike ndaj volumit prej 80 % vol. ose më e lartë, alkool etilik dhe alkoole të tjera të denatyruara, të çdo lloj force, për prodhim pijesh alkoolike		50 lekë/litri

- 22.08	Alkool etilik jo i denatyruar i një force alkoolike ndaj volumit prej më pak se 80 % vol., për prodhim pijesh alkoolike	50 lekë/litri"

Pas paragrafit të fundit, shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Personat juridikë a fizikë, vendas dhe të huaj, që importojnë alkool për prodhim pijesh alkoolike, do të deklarojnë në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve sasinë e alkoolit që do të importojnë, si dhe do të paraqesin dokumentin për pagesën e akcizës, sipas vlerës së përcaktuar në nenin 1 të këtij ligji."

Neni 2

Pas nenit 11 shtohet neni 11/1 me këtë përmbajtje:

"Nga sasia e pullave fiskale të tërhequra nga tatimpaguesi (prodhues dhe importues cigaresh), 0.5 për qind e saj pranohet si pullë fiskale e dëmtuar dhe hedhurinë.

Kjo sasi pullash fiskale, të dëmtuara brenda vitit kalendarik, do të zëvendësohet me pulla të reja fiskale dhe subjekti është i detyruar të paguajë vetëm vlerën e vetë pullës."

Neni 3

Pas nenit 11/1 shtohet neni 11/2 me këtë përmbajtje:

"Ministria e Financave dhe Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit përcaktojnë kategorinë për çdo lloj cigareje."

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2851, datë 26.12.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani